


Rregullatorët e presionit të serisë MR95



RREGULLATORËT E REDUKTIMIT TË PRESIONIT

Figura 1. Rregullatorët tipikë të presionit të serisë MR95

Specifikimet

Ky seksion përmban specifikimet për rregullatorët e serisë MR95. Specifikimet nga fabrika, të tilla si tipi, presioni maksimal në hyrje, temperatura maksimale, presioni maksimal në dalje, amplituda e sustës, madhësia e vrimave dhe materiali i sedies së sustës janë të stampuara në etiketën e identifikimit të pajisjes, e ngjitur mbi rregullator në fabrikë.

Konstruksionet e disponueshme

- Tipi MR95L:** Rregullator reduktues presioni për presione në dalje nga 0,14 deri 2,1 bar/2 deri 30 psig. Vetëm në madhësi trupi 1/4 deri 1 inç.
- Tipi MR95H:** Rregullator reduktues presioni për presione në dalje nga 0,34 deri 10,3 bar/5 deri 150 psig.
- Tipi MR95HP:** Rregullator reduktues presioni për presione në dalje nga 1,0 deri 2 7,6 bar/15 deri 400 psig (me sedie elastomere).
- Tipi MR95HT:** Rregullator reduktues presioni i temperaturës së lartë për presione në dalje nga 1,0 deri 20,7 bar/15 deri 300 psig (me sedie metalike) dhe deri në 343°C/650°F.
- Tipi MR95LD:** Rregullator reduktues presioni diferencial për presione diferenciale të vendosura nga 0,14 deri 2,1 bar/2 deri 30 psi me presion maksimal në hyrje deri në 20,7 bar/300 psi dhe me presion maksimal në dalje deri në 8,6 bar/125 psi. Vetëm në madhësi trupi 1/4 deri 1 inç.
- Tipi MR95HD:** Rregullator reduktues presioni diferencial për presione diferenciale të vendosura nga 0,34 deri 10,3 bar/5 deri 150 psi me presione maksimale në hyrje/dalje deri në 20,7 bar/300 psig.
- Tipi MR95HDP:** Rregullator reduktues presioni diferencial për presione diferenciale të vendosura nga 0,34 deri 10,3 bar/5 deri 150 psi me presione maksimale në hyrje/dalje deri në 41,4 bar/600 psi.

Madhësitë e trupit dhe vrimave

- Trup 1/4 NPT:** vrimë 7,22 mm/0,284 inç
- Trup DN 15/1/2 inç:** vrimë 10,56 mm/0,416 inç
- DN 20 dhe 25/3/4 dhe 1 inç Madhësitë e trupit:** Vrimë 16,02 mm/0,631 inç
- DN 40 dhe 50/1-1/2 dhe 2 inç Madhësitë e trupit (nuk disponohen për tipat MR95L dhe MR95LD):** vrimë 29 mm/1,142 inç

Llojet e lidhjes fundore

Shih tabelat 1 dhe 2

Diapazonet e presioneve në dalje dhe diferenciale⁽¹⁾

Shih tabelën 3

Presioni maksimal i ngarkimit në kutinë e sustës për tipat MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP

Shih tabelën 4

Presionet maksimale të punës në të ftohtë për madhësinë dhe materialet e trupit⁽¹⁾

Shih tabelën 4

Regjistrimi i presionit

I brendshëm ose i jashtëm

Klasifikimi i mbylljes sipas ANSI/FCI 70-3-2004

Sediet metalike: klasa IV

Sediet elastomere: klasa VI ose lart

PTFE: klasa IV

Diapazonet e temperaturës maksimale të materialeve të diafragmës dhe të sedies⁽¹⁾⁽²⁾

Shih tabelën 5

Koeficientet e prurjes dhe përcaktimit të madhësisë

Shih tabelën 6

Koeficientet e përcaktimit të madhësisë së shkarkimit për rregullatorët e serisë MR95 me vrima me prurje të reduktuar

Shih tabelën 7

Në përputhje me API 614

Konstruksionet prej çeliku ose çeliku të paoksidueshëm me veshje prej çeliku të paoksidueshëm plotësojnë kërkesat e API 614

Kapaciteti i shërbimit me gaz acid

Disponohen materiale opsionale për zbatime që përdorin gaze acide. Këto konstruksione përputhen me rekomandimet e standardet ndërkombëtare NACE MR0175-2002 dhe MR0103. Disponohen materiale opsionale për të plotësuar ANSI/NACE MR0175/ISO 15156.

Rregullimi i konfigurimit të presionit

Vidë regjistruese:

Standarde vetëm për tipat MR95L, MR95H, MR95HP dhe MR95HT

Dorezë manuale:

Standarde për tipat MR95LD, MR95HD, dhe MR95HDP. Opsionale për trupin me madhësi DN 15/1/2 inç të tipave MR95L, MR95H, MR95HP dhe MR95HT

Dorezë "T":

Opsionale për madhësitë e tjera të trupit (përveç DN 15/1/2 inç) të tipave MR95L, MR95H, MR95HP dhe MR95HT

1. Nuk duhet të tejkalohe kufijtë e presionit/temperaturës në këtë manual përdorimi dhe ato të çdo standardi ose rregulloreje të zbatueshme.
2. Presioni dhe/ose lidhja fundore në trup mund t'i ulë temperaturat maksimale.

Specifikimet (vazhdim)

Peshat e përafërta

Seria MR95H:

Trup 1/4 NPT: 2,3 kg/5 lbs
 Trup DN 15/1/2 inç: 4,5 kg/10 lbs
 DN 20 dhe 25/3/4 dhe 1 inç Madhësitë e trupit:
 10 kg/22 lbs
 DN 40 dhe 50/1-1/2 dhe 2 inç Madhësitë e trupit:
 25 kg/55 lbs

Seria MR95L:

Trup 1/4 NPT: 3,2 kg/7 lbs
 Trup DN 15/1/2 inç: 6,8 kg/15 lbs
 DN 20 dhe 25/3/4 dhe 1 inç Madhësitë e trupit:
 16 kg/35 lbs

Tabela 1. Konstruksionet e trupit të rregulatorit të tipit MR95L dhe MR95LD

MADHËSIA E TRUPIT	KONSTRUKSIONI I TRUPIT	LIDHJA FUNDORE	MATERIALI I TRUPIT				
			Gizë e hirtë	Çelik LC ose WCC	Çelik i paoksidueshëm CF8M ⁽¹⁾	Çelik i paoksidueshëm CF3M ⁽¹⁾	Monel [®] ose Hastelloy [®] C ⁽¹⁾
1/4 NPT	Pa linjë kontrolli dhe portë matjeje	NPT					
		SWE					
DN 15/1/2 inç	Pa linjë kontrolli dhe portë matjeje	CL150 RF e salduar					
		CL300 RF e salduar					
		PN 16/25/40 RF e salduar					
		NPT					
	Me linjë kontrolli, por pa portë matjeje	CL150 RF e salduar					
		CL300 RF e salduar					
		PN 16/25/40 RF e salduar					
		NPT					
DN 20/3/4 inç	Pa linjë kontrolli dhe portë matjeje	CL150 RF e salduar					
		CL300 RF e salduar					
		PN 16/25/40 RF e salduar					
		NPT					
	Me linjë kontrolli, por pa portë matjeje	CL150 RF e salduar					
		CL300 RF e salduar					
		PN 16/25/40 RF e salduar					
		NPT					
	Me portë matjeje, por pa linjë kontrolli	CL150 RF e salduar					
		CL300 RF e salduar					
		PN 16/25/40 RF e salduar					
		NPT					
DN 25/1 inç	Pa linjë kontrolli dhe portë matjeje	CL150 RF e salduar					
		CL300 RF e salduar					
		PN 16/25/40 RF e salduar					
		NPT					
	Me linjë kontrolli, por pa portë matjeje	CL150 RF e salduar					
		CL300 RF e salduar					
		PN 16/25/40 RF e salduar					
		NPT					
	Me portë matjeje, por pa linjë kontrolli	CL150 RF e salduar					
		CL300 RF e salduar					
		PN 16/25/40 RF e salduar					
		NPT					

■ - Zonat e mbushura tregojnë se konstruksioni është i disponueshëm.

□ - Zonat bosh tregojnë se ju duhet të kontaktoni zyrën lokale të shitjeve për të parë nëse konstruksionet janë të disponueshme.

1. Plotëson kërkesat kimike dhe fizike të NACE MR0175-2002 dhe NACE MR0103.

Monel[®] është një markë në pronësi të Special Metals Corporation.
 Hastelloy[®] C është një markë në pronësi të Haynes International, Inc.

Seria MR95

Tabela 2. Konstruksionet e trupit të rregullatorëve të tipit MR95H, MR95HD, MR95HDP, MR95HT dhe MR95HP

MADHËSIA E TRUPIT	KONSTRUKSIONI I TRUPIT	LIDHJA FUNDORE	MATERIALI I TRUPIT					
			Gizë e hirtë ⁽¹⁾	Çelik LCC ose WCC	Çelik i paoksidueshëm CF8M ⁽²⁾	Çelik i paoksidueshëm CF3M ⁽²⁾	Monel® ose Hastelloy® C ⁽²⁾	Alumin-bronz
1/4 NPT	Pa portë matjeje dhe linjë kontrolli	NPT						
DN 15/1/2 inç	Pa linjë kontrolli dhe portë matjeje	NPT						
		SWE						
		CL150 RF e salduar						
		CL300 RF e salduar						
		CL600 RF e salduar						
		PN 16/25/40 RF e salduar						
		CL150 RF integrale						
		CL300 RF integrale						
		CL600 RF integrale						
		PN 16/25/40 RF integrale						
	Me linjë kontrolli, por pa portë matjeje	NPT						
		CL150 RF e salduar						
		CL300 RF e salduar						
		CL600 RF e salduar						
PN 16/25/40 RF e salduar								
DN 20/3/4 inç	Pa portë matjeje dhe linjë kontrolli	NPT						
		SWE						
		CL150 RF e salduar						
		CL300 RF e salduar						
		CL600 RF e salduar						
		PN 16/25/40 RF e salduar						
	Me linjë kontrolli, por pa portë matjeje	NPT						
		CL150 RF e salduar						
		CL300 RF e salduar						
		PN 16/25/40 RF e salduar						
	Me portë matjeje, por pa linjë kontrolli	NPT						
		CL150 RF e salduar						
		CL300 RF e salduar						
		PN 16/25/40 RF e salduar						
DN 25/1 inç	Pa portë matjeje dhe linjë kontrolli	NPT						
		SWE						
		CL150 RF e salduar						
		CL300 RF e salduar						
		CL600 RF e salduar						
		PN 16/25/40 RF e salduar						
		CL150 RF integrale						
		CL300 RF integrale						
		CL600 RF integrale						
		PN 16/25/40 RF integrale						

- Zonat e mbushura tregojnë se konstruksioni është i disponueshëm.
 - Zonat bosh tregojnë se ju duhet të kontaktoni zyren lokale të shitjeve për të parë nëse konstruksionet janë të disponueshme.
 1. Materiali i trupit prej gize të hirtë disponohet vetëm për tipat MR95H dhe MR95HD.
 2. Plotëson kërkesat kimike dhe fizike të NACE MR0175-2002 dhe NACE MR0103.

- vazhdim -

Monel® është një markë në pronësi të Special Metals Corporation.
 Hastelloy® C është një markë në pronësi të Haynes International, Inc.

Tabela 2. Konstruksionet e trupit të rregullatorëve të tipit MR95H, MR95HD, MR95HDP, MR95HT dhe MR95HP (vazhdim)

MADHËSIA E TRUPIT	KONSTRUKSIONI I TRUPIT	LIDHJA FUNDORE	MATERIALI I TRUPIT						
			Gizë e hirtë ⁽¹⁾	Çelik LCC ose WCC	Çelik i paoksidueshëm CF8M ⁽²⁾	Çelik i paoksidueshëm CF3M ⁽²⁾	Monel® ose Hastelloy® C ⁽²⁾	Alumin-bronz	
DN 25/1 inç	Me linjë kontrolli, por pa portë matjeje	NPT							
		CL150 RF e salduar							
		CL300 RF e salduar							
		PN 16/25/40 RF e salduar							
	Me portë matjeje, por pa linjë kontrolli	NPT							
		CL150 RF e salduar							
		CL300 RF e salduar							
		PN 16/25/40 RF e salduar							
DN 40/1-1/2 inç	Pa portë matjeje dhe linjë kontrolli	NPT							
		SWE							
		CL150 RF e salduar							
		CL300 RF e salduar							
		CL600 RF e salduar							
		PN 16/25/40 RF e salduar							
	Me linjë kontrolli, por pa portë matjeje	NPT							
		CL150 RF e salduar							
		CL300 RF e salduar							
		PN 16/25/40 RF e salduar							
	Me portë matjeje, por pa linjë kontrolli	NPT							
		CL150 RF e salduar							
		CL300 RF e salduar							
		PN 16/25/40 RF e salduar							
	DN 50/2 inç	Pa portë matjeje dhe linjë kontrolli	NPT						
			SWE						
CL150 RF e salduar									
CL300 RF e salduar									
CL600 RF e salduar									
PN 16/25/40 RF e salduar									
CL150 RF integrale									
CL300 RF integrale									
CL600 RF integrale									
PN 16/25/40 RF integrale									
Me linjë kontrolli, por pa portë matjeje		NPT							
		CL150 RF e salduar							
		CL300 RF e salduar							
		PN 16/25/40 RF e salduar							
Me portë matjeje, por pa linjë kontrolli		NPT							
		CL150 RF e salduar							
	CL300 RF e salduar								
	PN 16/25/40 RF e salduar								

- Zonat e mbushura tregojnë se konstruksioni është i disponueshëm.
 - Zonat bosh tregojnë se ju duhet të kontaktoni zyrën lokale të shitjeve për të parë nëse konstruksionet janë të disponueshme.
 1. Materiali i trupit prej gize të hirtë disponohet vetëm për tipat MR95H dhe MR95HD.
 2. Plotëson kërkesat kimike dhe fizike të NACE MR0175-2002 dhe NACE MR0103.

Monel® është një markë në pronësi të Special Metals Corporation.
 Hastelloy® C është një markë në pronësi të Haynes International, Inc.

Seria MR95

Tabela 3. Seria MR95: Diapazonet e presioneve në dalje dhe diferenciale dhe informacioni rreth sustës

TIPI	MADHËSIA E TRUPIT		DIAPAZONI I PRESIONEVE NË DALJE OSE DIFERENCIALE ⁽¹⁾		DIAMETRI I TELIT TË SUSTËS		GJATËSIA E LIRË E SUSTËS		MATERIALI I SUSTËS ⁽²⁾	NUMRI I PJESESË SË SUSTËS	NGJYRA E SUSTËS
	DN	Inç	bar	psi/psig	mm	Inç	mm	Inç			
MR95L dhe MR95LD	----	1/4	0,14 deri 0,41	2 deri 6	3,76	0,148	50,8	2,00	Çelik i zinkuar	1E392527022	E verdhë
			0,34 deri 1,0	5 deri 15	4,32	0,170	50,8	2,00	Çelik i zinkuar	ERAA01888A0	E gjelbër
			0,90 deri 2,1	13 deri 30	5,26	0,207	49,2	1,94	Çelik i veshur me pluhur	ERAA01889A0	E kuqe
	15	1/2	0,14 deri 0,41	2 deri 6	5,26	0,207	63,5	2,50	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	ERCA04288A0	E verdhë
			0,34 deri 1,0	5 deri 15	5,94	0,234	65,9	2,60	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	ERAA01910A0	E gjelbër
			0,90 deri 2,1	13 deri 30	7,19	0,283	62,0	2,44	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	ERAA01911A0	E kuqe
	20 dhe 25	3/4 dhe 1	0,14 deri 0,41	2 deri 6	7,77	0,306	102	4,00	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	1E398927022	E verdhë
			0,34 deri 1,0	5 deri 15	8,71	0,343	102	4,00	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	1E399027142	E gjelbër
			0,90 deri 2,1	13 deri 30	10,31	0,406	102	4,00	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	1E399127162	E kuqe
			0,14 deri 0,41	2 deri 6	7,77	0,306	102	4,00	Çelik i paoksidueshëm i veshur me pluhur	1E3989X0052	E verdhë
			0,34 deri 1,0	5 deri 15	9,53	0,375	98,6	3,88	Çelik i paoksidueshëm	1K762537022	I palyer
			0,90 deri 2,1	13 deri 30	11,1	0,437	102	4,00	Çelik i paoksidueshëm	11A8269X012	I palyer
MR95H, MR95HD dhe MP95HDP	----	1/4	1,0 deri 2,1	15 deri 30	3,76	0,148	50,8	2,00	Çelik i zinkuar	1E392527022	E verdhë
			1,7 deri 5,2	25 deri 75	4,32	0,170	50,8	2,00	Çelik i zinkuar	ERAA01888A0	E gjelbër
			4,8 deri 10,3	70 deri 150	5,26	0,207	49,2	1,94	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	ERAA01889A0	E kuqe
	15	1/2	1,0 deri 2,1	15 deri 30	5,26	0,207	63,5	2,50	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	ERCA04288A0	E verdhë
			1,7 deri 5,2	25 deri 75	5,94	0,234	65,9	2,60	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	ERAA01910A0	E gjelbër
			4,8 deri 10,3	70 deri 150	7,19	0,283	62,0	2,44	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	ERAA01911A0	E kuqe
	20 dhe 25	3/4 dhe 1	1,0 deri 2,1	15 deri 30	7,77	0,306	102	4,00	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	1E398927022	E verdhë
			1,7 deri 5,2	25 deri 75	8,71	0,343	102	4,00	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	1E399027142	E gjelbër
			4,8 deri 10,3	70 deri 150	10,31	0,406	102	4,00	Çelik i veshur me pluhur ⁽³⁾	1E399127162	E kuqe
			1,0 deri 2,1	15 deri 30	7,77	0,306	102	4,00	Çelik i paoksidueshëm i veshur me pluhur	1E3989X0052	E verdhë
			1,7 deri 5,2	25 deri 75	9,53	0,375	98,6	3,88	Çelik i paoksidueshëm	1K762537022	I palyer
			4,8 deri 10,3	70 deri 150	11,1	0,437	102	4,00	Çelik i paoksidueshëm	11A8269X012	I palyer
	40 dhe 50	1-1/2 dhe 2	0,34 deri 5,5	5 deri 80	12,7	0,500	165	6,50	Çelik i veshur me pluhur	ERCA04290A0	E zezë me vijë blu të hapur
			4,1 deri 8,3	60 deri 120	14,3	0,562	167	6,56	Çelik i veshur me pluhur	ERAA01893A0	Gri e hapur
			6,9 deri 9,7	100 deri 140	15,1	0,594	167	6,56	Çelik i emaluar	ERAA01894A0	E verdhë
			8,3 deri 10,3	120 deri 150	15,9	0,625	167	6,57	Çelik i veshur me pluhur	1P7888X0022	E zezë
			0,34 deri 4,1	5 deri 60	12,7	0,5	165	6,5	Inconel®	ERAA09035A0	I palyer
			3,4 deri 8,3	50 deri 120	15,9	0,625	165	6,5	Inconel®	ERAA08881A0	I palyer
MR95HT	----	1/4	1,0 deri 6,9	15 deri 100	4,88	0,192	50,8	2,00	Inconel®	ERCA04292A0	I palyer
			5,5 deri 20,7	80 deri 300	7,14	0,281	50,8	2,00	Inconel®	ERCA04291A0	I palyer
	15	1/2	1,0 deri 6,9	15 deri 100	7,14	0,281	63,5	2,50	Inconel®	ERCA04294A0	I palyer
			5,5 deri 20,7	80 deri 300	9,53	0,375	66,0	2,60	Inconel®	ERCA04293A0	I palyer
	20 dhe 25	3/4 dhe 1	1,0 deri 6,9	15 deri 100	11,1	0,437	104	4,08	Çelik i paoksidueshëm 17-4 PH	ERCA04295A0	I palyer
			5,5 deri 20,7	80 deri 300	14,3	0,562	104	4,08	Çelik i paoksidueshëm 17-4 PH	ERCA04296A0	I palyer
	40 dhe 50	1-1/2 dhe 2	1,0 deri 6,9	15 deri 100	15,9	0,625	170	6,70	Çelik i paoksidueshëm 17-4 PH	ERCA04297A0	I palyer
			4,1 deri 17,9	60 deri 260	20,6	0,812	170	6,70	Çelik i paoksidueshëm 17-4 PH	ERCA04298A0	I palyer
MR95HP	----	1/4	1,0 deri 6,9	15 deri 100	4,88	0,192	50,8	2,00	Inconel®	ERCA04292A0	I palyer
			5,5 deri 27,6	80 deri 400	7,14	0,281	50,8	2,00	Inconel®	ERCA04291A0	I palyer
			1,0 deri 6,9	15 deri 100	7,14	0,281	63,5	2,50	Inconel®	ERCA04294A0	I palyer
	15	1/2	5,5 deri 27,6	80 deri 400	9,53	0,375	66,0	2,60	Inconel®	ERCA04293A0	I palyer
			1,0 deri 6,9	15 deri 100	11,1	0,437	104	4,08	Çelik i paoksidueshëm 17-4 PH	ERCA04295A0	I palyer
			5,5 deri 27,6	80 deri 400	14,3	0,562	104	4,08	Çelik i paoksidueshëm 17-4 PH	ERCA04296A0	I palyer
	40 dhe 50	1-1/2 dhe 2	1,0 deri 6,9	15 deri 100	15,9	0,625	170	6,70	Çelik i paoksidueshëm 17-4 PH	ERCA04297A0	I palyer
			4,1 deri 20,7	60 deri 300	20,6	0,812	170	6,70	Çelik i paoksidueshëm 17-4 PH	ERCA04298A0	I palyer

1. Për rregullatorët e tipave MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP, diapazonet e presionit tregojnë presionin diferencial që mund të përftohet me sustën e treguar. Presioni diferencial (konfigurimi i sustës) i shtohet presionit të ngarkimit në kutinë e sustës për të përcaktuar presionin real në dalje.
 2. Sustat plotësojnë kërkesat NACE MR0175-2002 dhe NACE MR0103 vetëm për përdorime në të cilat ato nuk ekspozohen ndaj gazit acid.
 3. I disponueshëm në Inconel®.

Tabela 4. Presionet maksimale të punës në të ftohtë për madhësinë dhe materialet e trupit⁽¹⁾⁽²⁾

TIPI	MADHËSIA E TRUPIT	MATERIALI I TRUPIT	PRESIONI MAKSIMAL NË HYRJË		PRESIONI MAKSIMAL NË DALJE		PRESIONI MAKSIMAL I KUTISË SË SUSTËS	
			bar	psig	bar	psig	bar	psig
MR95L dhe MR95LD	Të gjitha madhësitë e disponueshme ⁽³⁾	Gizë e hirtë	17,2	250	3,4	50	3,4	50
		Çelik WCC	20,7	300	8,6	125	8,6	125
		Çelik LCC	20,7	300	8,6	125	8,6	125
		Çelik i paoksidueshëm CF8M	20,7	300	8,6	125	8,6	125
		Çelik i paoksidueshëm CF3M	20,7	300	8,6	125	8,6	125
		Monel ⁽⁴⁾	20,7	300	8,6	125	8,6	125
		Hastelloy® C ⁽⁴⁾	20,7	300	8,6	125	8,6	125
MR95H dhe MR95HD	Të gjitha madhësitë e disponueshme ⁽³⁾	Gizë e hirtë	17,2	250	17,2	250	17,2	250
		Çelik WCC	20,7	300	20,7	300	20,7	300
		Çelik LCC	20,7	300	20,7	300	20,7	300
		Çelik i paoksidueshëm CF8M	20,7	300	20,7	300	20,7	300
		Çelik i paoksidueshëm CF3M	20,7	300	20,7	300	20,7	300
		Monel ⁽⁴⁾	20,7	300	20,7	300	20,7	300
		Hastelloy® C ⁽⁴⁾	20,7	300	20,7	300	20,7	300
MR95HDP	Të gjitha madhësitë e disponueshme ⁽³⁾	Alumin-bronz ⁽⁴⁾	20,7	300	20,7	300	20,7	300
		Çelik WCC	41,4	600	41,4	600	41,4	600
		Çelik LCC	41,4	600	41,4	600	41,4	600
		Çelik i paoksidueshëm CF8M	41,4	600	33,9	550	33,9	550
		Çelik i paoksidueshëm CF3M	41,4	600	33,9	550	33,9	550
		Monel ⁽⁴⁾	41,4	600	33,9	550	33,9	550
		Hastelloy® C ⁽⁴⁾	41,4	600	33,9	550	33,9	550
MR95HP	Të gjitha madhësitë e disponueshme ⁽³⁾	Alumin-bronz ⁽⁴⁾	41,4	600	33,9	550	33,9	550
		Çelik WCC	68,9	1000	41,4	600	41,4	600
		Çelik LCC	68,9	1000	41,4	600	41,4	600
		Çelik i paoksidueshëm CF8M	68,9	1000	37,9	550	37,9	550
		Çelik i paoksidueshëm CF3M	68,9	1000	37,9	550	37,9	550
		Monel ⁽⁴⁾	68,9	1000	37,9	550	37,9	550
		Hastelloy® C ⁽⁴⁾	68,9	1000	37,9	550	37,9	550
MR95HT	1/4 NPT dhe DN 15 deri 25/1/2 deri 1 inç	Alumin-bronz ⁽⁴⁾	68,9	1000	37,9	550	37,9	550
		Çelik WCC	41,4	600	41,4	600	41,4	600
		Çelik LCC	41,4	600	41,4	600	41,4	600
		Çelik i paoksidueshëm CF8M	41,4	600	37,9	550	37,9	550
		Çelik i paoksidueshëm CF3M	41,4	600	37,9	550	37,9	550
		Monel ⁽⁴⁾	41,4	600	37,9	550	37,9	550
		Hastelloy® C ⁽⁴⁾	41,4	600	37,9	550	37,9	550
	DN 40 dhe 50/1-1/2 dhe 2 inç	Alumin-bronz ⁽⁴⁾	41,4	600	37,9	550	37,9	550
		Çelik WCC	41,4	600	31,0	450	31,0	450
		Çelik LCC	41,4	600	31,0	450	31,0	450
		Çelik i paoksidueshëm CF8M	41,4	600	31,0	450	31,0	450
		Çelik i paoksidueshëm CF3M	41,4	600	31,0	450	31,0	450
		Monel ⁽⁴⁾	41,4	600	31,0	450	31,0	450
		Hastelloy® C	41,4	600	31,0	450	31,0	450

1. Nuk duhet të tejkalohen kufijtë e presionit/temperaturës në këtë manual përdorimi dhe ato të çdo standardi ose rregulloreje të zbatueshme.
2. Kufijtë e dhënë të presionit janë bazuar vetëm mbi madhësinë dhe materialet e trupit. Kufijtë reale të presionit të rregullatorit të montuar mund të ulen dhe ndryshojnë në varësi të temperaturës, lidhjes fundore të trupit, diafragmës, materialit të sedies dhe/ose të veshj së rregullatorit.
3. Shih tabelat 1 dhe 2 për të gjitha madhësitë e disponueshme të trupit.
4. Nuk disponohet për madhësinë e trupit 1/4 NPT.

Seria MR95

Tabela 5. Kapacitetet e temperaturës së serisë MR95⁽¹⁾⁽²⁾

MATERIALI I VESHJES	SEDIA	DIAFRAGMA	UNAZA HERMETIZUESE	MBROJTËSI I DIAFRAGMËS	PERMISTOPI	TEMPERATURA	
						°C	°F
Nitril (NBR)	✓		✓			-40 deri 82	-40 deri 180
Neopren (CR)		✓				-40 deri 82	-40 deri 180
Fluorokarbon (FKM) ⁽³⁾	✓	✓	✓			-18 deri 149, I kufizuar në 93°C për ujin e nxehtë	0 deri 300, I kufizuar në 200°F për ujin e nxehtë
Etilen propilen (EPDM)	✓	✓	✓			-7 deri 135	20 deri 275
Elastomer perfluori (FFKM)	✓		✓			-18 deri 218	0 deri 425
PTFE	✓			✓		-40 deri 204	-40 deri 400
Metal	✓	✓				-40 deri 343	-40 deri 650
I përbërë					✓	-40 deri 204, I kufizuar në 149°C për avullin	-40 deri 400, I kufizuar në 300°F për avullin
Grafit					✓	-40 deri 343	-40 deri 650
MATERIALI I TRUPIT						TEMPERATURA	
						°C	°F
Gizë e hirtë						-29 deri 208	-20 deri 406
Çelik WCC ⁽⁴⁾						-29 deri 343	-20 deri 650
Çelik LCC ⁽⁴⁾						-40 deri 343	-40 deri 650
Çelik i paoksidueshëm ⁽⁴⁾ , Monel® ose Hastelloy® C						-40 deri 288	-40 deri 550
Alumin-bronz						-40 deri 260	-40 deri 500

1. Nuk duhet të tejkalohen kufijtë e presionit/temperaturës në këtë manual përdorimi dhe ato të çdo standardi të zbatueshëm.
 2. Kufijtë e dhënë të temperaturës janë bazuar vetëm mbi madhësinë dhe materialet e trupit. Kufijtë reale të temperaturës së rregullatorit të montuar mund të ulen dhe ndryshojnë në varësi të lidhjes fundore të trupit, diafragmës, materialit të sedies dhe/ose të veshjes së rregullatorit.
 3. Nuk përdoret në shërbimin e avullit.
 4. Plotëson kërkesat API 614 (me veshje prej çeliku të paoksidueshëm).

Tabela 6. Koeficienti i prurjes dhe përcaktimit të madhësisë për tipat MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP

MADHËSIA E TRUPIT		KOEFIENI I HAPJES SË PLOTË (PËR PËRCAKTIMIN E MADHËSISË SË SHKARKIMIT)			C ₁	K _M	KOEFIENI I IEC PËR PËRCAKTIMIN E MADHËSISË		
DN	Inç	C _V	C _G	C _S			X _T	F _D	F _L
---	1/4 NPT	1,1	37	1,85	33,6	0,74	0,715	0,62	0,86
15	1/2	2,9	103	5,15	35,5	0,79	0,797	0,70	0,89
20 dhe 25	3/4 dhe 1	6,0	221	11,05	36,8	0,88	0,857	0,68	0,94
40 dhe 50	1-1/2 dhe 2	18,1	700	35,00	38,7	0,88	0,945	0,65	0,94

$K_m = F_L^2$

Tabela 7. Koeficientet e përcaktimit të madhësisë së shkarkimit për rregullatorët e serisë MR95 me vrima me prurje të reduktuar⁽¹⁾

MADHËSIA E TRUPIT		KOEFIENI I HAPJES SË PLOTË PËR SERINË MR95, OPSIONI ME PRURJE TË REDUKTUAR	KOEFIENI I HAPJES SË PLOTË PËR SERINË 95 TË MËPARSHME
DN	Inç	C _B	C _B
---	1/4 NPT	28	28
15	1/2	70	67
20 dhe 25	3/4 dhe 1	156	156
40 dhe 50	1-1/2 dhe 2	482	475

1. Opsioni i vrimës me prurje të reduktuar ofron kapacitet të ngjashëm prurjeje si konfiguracioni ekuivalent i serisë 95.

Monel® është një markë në pronësi të Special Metals Corporation.
 Hastelloy® C është një markë në pronësi të Haynes International, Inc.

**PARALAJMËRIM**

Mosndjekja e këtyre udhëzimeve ose instalimi dhe mirëmbajta e gabuar e kësaj pajisjeje mund të çojë në shpërthim, zjarr dhe/ose ndotje kimike që shkaktojnë dëme materiale dhe dëmtime fizike ose vdekje.

Rregullatorët Fisher™ duhet të instalohen, përdoren dhe mirëmbahen në përputhje me kodet, rregullat dhe rregulloret federale, shtetërore dhe vendase, si dhe me udhëzimet “Emerson Process Management Regulator Technologies, Inc.”, (Emerson).

Nëse nga rregullatori del gaz apo nëse shfaqen rrjedhje në sistem, atëherë mund të kërkohej shërbim teknik i njësisë. Moskorrigjimi i problemit mund të çojë në kushte të rrezikshme.

Procedurat e instalimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes të kryera nga personel i pakualifikuar mund të çojë në regjistrim të gabuar ose në përdorim të pasigurt. Secila nga këto situata mund të çojë në dëmtim të pajisjeve ose në dëmtim fizik. Instalimi dhe shërbimi teknik i rregullatorit të serisë MR95 duhet të bëhet vetëm nga një person i kualifikuar.

Hyrje**Qëllimi i manualit**

Ky manual jep udhëzime për instalimin, regjistrimin, mirëmbajtjen dhe porositjen e pjesëve për rregullatorët e presionit të serisë MR95. Këta rregullatorë zakonisht dërgohen ndarazi për montim në linjë ose në panel ose të instaluar në pajisje të tjera. Udhëzimet dhe listat e pjesëve për pajisjet e tjera gjenden në manuale të veçanta.

Përshkrimi i produktit

Rregullatorët e reduktimit të presionit dhe presionit diferencial të serisë MR95 janë të përshtatshëm për një larmi agjentësh të lëngshëm, përfshirë shërbimet e lëngut, gazit, ajrit dhe avullit.

Përdorimet tipike përfshijnë përdorimin, por jo vetëm, në depozitat e larjes, nxehtësitë e vegjël, linjat e karburantit dhe vajit, sistemet e furnizimit me ajër, pajisje të provës dhe sterilizatorë.

Rregullatorët e reduktimit të presionit

Rregullatorët e tipit MR95L, MR95H, MR95HP dhe MR95HT janë rregullatorë reduktues presioni me operim të drejtpërdrejtë për kontroll presioni që kërkon presione konstante në dalje midis 0,14 deri 27,6 bar/2 deri 400 psig.

Rregullatorët e presionit diferencial

Rregullatorët e tipit MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP janë rregullatorë reduktues presioni diferencial me operim të drejtpërdrejtë me diapazon presioni diferencial nga 3,4 deri 10,3 bar /2 deri 150 psi.

Shihni tabelat 1 deri 6 për ndarjen e detajuar të ofertave të ndryshmeve të konstruksioneve. Rregullatorët tipikë të serisë MR95 tregohen në figurën 1.

Parimi i punës**Për rregullatorët e reduktimit të presionit të tipit MR95H, MR95L, MR95HP dhe MR95HT**


Tipat MR95L, MR95H, MR95HP dhe MR95HT (shihni figurën 2) janë rregullatorë me operim të drejtpërdrejtë dhe përdorin forcën e sustës për të rregulluar presionin në dalje. Presioni pas rregullatorit regjistrohet ose nga brenda përmes trupit, ose nga jashtë përmes një linje kontrolli në anën e poshtme të diafragmës. Kur presioni pas rregullatorit është i barabartë ose më lart presionit të caktuar, disku mbahet kundrejt dizës, duke kufizuar kalimin përmes rregullatorit. Kur kërkesa rritet, presioni pas rregullatorit bie pak, çka lejon zgjerimin e sustës, duke e lëvizur bishtin poshtë dhe diskun larg vrimës. Kjo e lejon rrjedhjen e lëngut përmes trupit për në pjesën e poshtme.

Për rregullatorët e presionit diferencial të tipit MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP

Rregullatorët e tipit MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP ruajnë një presion diferencial midis presionit të ngarkimit dhe presionit pas rregullatorit.

Shihni figurën 2. Dizajni i rregullatorit izolon diafragmën dhe dhomën e reagimit të presionit nga rrjedha e prurjes kryesore. Presioni pas rregullatorit (presioni në dalje) regjistrohet poshtë diafragmës përmes tubit Pitot ose vrimës së regjistrimit. Nëse presioni pas rregullatorit rritet, rritet gjithashtu

Seria MR95



M1232_08/2013

PAMJE BALLORE DHE E BRENDSHME E TIPIT MR95H ME REGJISTRIM TË BRENDSHËM TË PRESIONIT


M1231_08/2013

PAMJE E PASME E DN 15/1/2 INÇ TIPI MR95H ME REGJISTRIM TË JASHTËM TË PRESIONIT

M1231_08/2013


PAMJE ANËSORE DHE E BRENDSHME E TIPIT MR95H DN 20 DERI 50/3/4 DERI 2 INÇ TIPI MR95H ME REGJISTRIM TË JASHTËM TË PRESIONIT (TIPIKE EDHE PËR TIPAT MR95L, DN 15 DERI 50/1/2 DERI 2 INÇ MADHËSITË E TRUPIT)

- PRESIONI NË HYRJE
- PRESIONI NË DALJE
- PRESIONI ATMOSFERIK



M1231_08/2013

TIPI MR95H ME 2 DIAFRAGMA METALIKE (GJITHASHTU TIPIKE E TIPAVE MR95HT DHE MR95L, PËRVEÇ TIPIT MR95L ME MADHËSI TRUPI 1/4 NPT, ME DIAPAZON 0,14 DERI 0,41 bar/2 DERI 6 psi)



M1236_08/2013

TIPI MR95L (ME DIAPAZON 1/4 NPT, 0,14 DERI 0,41 bar/2 DERI 6 psi) ME DIAFRAGMË METALIKE

Figura 2. Skema operationale e serisë MR95

edhe presioni poshtë diafragmës. Kjo forcë kapërcen shtypjen e sustës dhe presionin e ngarkimit, çka lejon ngritjen e bishtit. Susta e fluturës së valvulës e shtyn fluturën e valvulës më afër dizës. Qarkullimi në rregullator reduktohet, në mënyrë të tillë që presioni pas rregullatorit të kthehet në nivelin e dëshiruar diferencial.

Kur presioni pas rregullatorit ulet, ndodh veprimi i kundërt. Presioni poshtë diafragmës ulet. Bishti i valvulës e shtyn poshtë fluturën e valvulës, duke hapur rrjedhën e qarkullimit dhe duke rritur qarkullimin e fluidit përmes rregullatorit. Presioni pas rregullatorit ngrihet sërish në nivelin e dëshiruar diferencial.




Figura 2. Skema operationale e serisë MR95 (vazhdim)




Figura 3. Skema e instalimit të rregullatorit të presionit diferencial

Instalimi

PARALAJMËRIM

Mund të shkaktohen dëme fizike ose të sistemit nëse ky rregullator instalohet pa mbrojtjen e duhur kundër mbipresionit, ku kushtet e shërbimit mund të tejkalojnë kufijtë e dhënë në seksionin e specifikimeve dhe/ose në etiketën e identifikimit të rregullatorit. Shihni seksionin “Mbrojtja kundër mbipresionit” për rekomandime në lidhje me mënyrën e parandalimit të tejkalimit të këtyre kufijve nga kushtet e shërbimit. Përveç kësaj, dëmtimi fizik i rregullatorit mund të çojë në lëndim fizik të njerëzve ose dëme materiale për shkak të daljes së

gazit të akumuluar. Për të evituar dëme të tilla personale ose materiale, rregullatori duhet instaluar në një vend të sigurt.

Në kushte të mbyllura ose ambiente të mbyllura, gazit që del mund të akumulohet dhe të përbëjë një rrezik shpërthimi. Në këtë rast, vrima e ajrit duhet të shtrihen me tuba deri jashtë.

Për konstruksionet e rregullatorëve me valvul shkarkimi me sustë, valvula e shkarkimit duhet mbajtur hapur për të lejuar daljen e lirë të gazit në atmosferë. Vrimat duhen mbrojtur kundër hyrjes së shiut, borës, insekteve ose çdo materiali tjetër të huaj që mund të bllokojnë valvulën e shkarkimit të kutisë së sustës ose linjën e shkarkimit.

Të gjitha pajisjet e presionit duhet të instalohen në një zonë josizmike; nuk duhet të ekspozohen ndaj zjarrit; dhe duhen mbrojtur nga goditjet e rrufesë (vetëtimës).

Para se të instaloni rregullatorin:

- Hiqeni atë nga ambalazhi dhe largoni tapat mbrojtëse të transportit nga lidhjet e trupit dhe lidhja e presionit në kutinë e sustës.
- Kontrolloni rregullatorin dhe sigurohuni që ai nuk është dëmtuar apo nuk ka materiale të huaja të mbledhura gjatë transportit.
- Hiqni mbetjen e ngurta ose baltën në tuba dhe tubacion.
- Vendosni pastën e tubave në filetën e jashtme të tubit për trupat NPT ose përdorni permistopët e duhur për trupat që lidhen me flanxhë.
- Sigurohuni që rrjedhja e gazit përmes rregullatorit është në të njëjtin drejtim me shigjetën në trup.

Në DN 40 ose 50/1-1/2 ose 2 inç Te rregullatorët e tipit MR95H, MR95HP dhe MR95HT, valvula e shkarkimit është e mbyllur me tapë, për të lejuar lidhjen e një linje shkarkimi që siguron ajrimin në një vend të largët. Në 1/4 NPT, DN 15, 20 dhe 25 /1/2, 3/4 dhe 1 inç Për madhësitë e trupit të tipit MR95H, MR95HP dhe MR95HT, opsioni i vrimës së ajrimit me tapë ofrohet sipas kërkesës. Mbroni anën e ekspozuar të tubit të shkarkimit me një komplet shkarkimi rezistues ndaj motit dhe insekteve. Kontrolloni periodikisht të gjitha valvulat e shkarkimit dhe linjat e shkarkimit në distancë për t'u siguruar që ato nuk janë të bllokuara.

Te rregullatorët e tipit MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP, presioni i ngarkimit është i lidhur në pikën e lidhjes 1/4 NPT në kutinë e sustës.

Mbrojtja kundër mbipresionit

PARALAJMËRIM

Mund të shkaktohet lëndim i personave, dëmtim i pajisjeve ose rrjedhje për shkak të çlirimit të gazit të akumuluar ose shpërthimit të pjesëve nën presion nëse rregullatori:

- është në mbipresion
- instalohet në një vend ku kushtet e shërbimit mund të tejkalojnë kufijtë e dhënë në seksionin e specifikimeve dhe/ose në etiketën e identifikimit të rregullatorit
- është në kushte të tilla që tejkalojnë çdo normë të tubacioneve përbri ose lidhjeve të tubacioneve

Për të evituar dëmtime të tilla fizike ose materiale, duhet të siguroni pajisje të çlirimit ose kufizimit të presionit që pengojnë tejkalimin e këtyre kufijve nga ana e kushteve të shërbimit.

Rregullatorët e tipit MR95H dhe MR95HD kanë një normë presioni në dalje të barabartë me normën e presionit në hyrje. Rregullatorët e tipit MR95L, MR95LD, MR95HDP, MR95HP dhe MR95HT kanë një normë presioni në dalje më të ulët sesa norma e presionit në hyrje.

Kufizimet e rekomanduara të presionit janë stampuar në etiketën e identifikimit të rregullatorit. Është e nevojshme një lloj i caktuar i mbrojtjes kundër mbipresionit nëse presioni aktual në hyrje tejkalon normën maksimale të punës të presionit në dalje. Siguroni mbrojtje kundër mbipresionit nëse presioni në hyrje i rregullatorit është më i madh sesa presioni i punës së sigurt të pajisjes pas rregullatorit.

Metoda të zakonshme të mbrojtjes së jashtme kundër mbipresionit përfshijnë valvula shkarkimi, rregullatorë monitorimi, pajisje ndarëse dhe rregullim në seri.

Puna e rregullatorit poshtë kufizimeve të presionit maksimal nuk përjashton mundësinë e dëmtimit nga burime të jashtme ose nga mbetjet e ngurta në tubacion. Nëse rregullatori është i ekspozuar ndaj një gjendjeje mbipresioni, duhet ta inspektoni nëse ka ndodhur ndonjë dëmtim.

Vënia në punë

Shënim

Seksioni i specifikimeve dhe tabelat 3 dhe 4 tregojnë presionet maksimale në hyrje, presionet diferenciale dhe ato në dalje për konstruksione specifike. Përdorni manometra për të monitoruar presionin në hyrje, presionin në dalje dhe presionin e ngarkimit gjatë vënies në punë.

1. Verifikoni nëse është bërë instalimi i saktë dhe që pajisja pas rregullatorit është regjistruar siç duhet.
2. Sigurohuni që të jenë të mbyllura të gjitha valvulat e bllokimit dhe të shkarkimit.
3. Shtendosni sustën e kontrollit duke rrotulluar në drejtim kundërorar vidën regjistruese (për tipin MR95L, MR95H, MR95HP dhe MR95HT) ose dorezën (për tipin MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP).
4. Hapini më ngadalë valvulat sipas rendit të mëposhtëm:
 - a. Furnizimin e ngarkimit dhe valvulën (valvulat) e linjës së kontrollit, nëse përdoren
 - b. Valvulën e bllokimit në hyrje
 - c. Valvulën e bllokimit në dalje
5. Vendoseni rregullatorin në presionin e dëshiruar në dalje (e kontrollit) në përputhje me procedurën e axhustimit.

Axhustimi

PARALAJMËRIM

Për të evituar dëmtime personale fizike, dëme materiale ose të pajisjeve të shkaktuara nga pjesët nën presion ose shpërthimi i gazit të akumuluar, mos e rregulloni asnjëherë sustën e kontrollit në mënyrë të tillë që të prodhohet një presion në dalje më i lartë sesa kufiri i sipërm i diapazonit të presionit në dalje për sustën në fjalë. Nëse presioni i dëshiruar në dalje nuk është brenda diapazonit të sustës së kontrollit, instaloni një sustë me diapazonin e duhur.

Cilësimet nga fabrika të rregullatorit mund të ndryshohen brenda diapazonit të presionit të stampuar mbi etiketën e identifikimit. Për rregullimin e duhur të sustës së daljes (kontrollit), ndiqni procedurat e mëposhtme. Nëse ka ndryshuar diapazoni i sustës, sigurohuni që ta ndërroni diapazonin e stampuar të sustës në etiketën e identifikimit.

Të gjitha sustat e rregullatorit të serisë MR95 mund të mbështeten për të siguruar dalje zero. Në tabelat 3 dhe 4 tregohen diapazonet e disponueshme të presionit në dalje, presionet maksimale në hyrjet dhe kodet e ngjyrave të sustave përkatëse.

Tipat MR95L, MR95H, MR95HP dhe MR95HT

Numrat e identifikimit referohen në figurat 6, 8 ose 9.

1. Lironi kundërdadon (nr. 17).
2. Rrotullojeni në drejtim orar vidën regjistruese (nr. 15) për të rritur presionin në dalje ose në drejtim kundërorar për ta ulur atë.
3. Gjatë axhustimit, monitoroni presionin në dalje me një manometër prove.
4. Shtërngoni kundërdadon (nr. 17) për të ruajtur cilësimin e dëshiruar.

Tipat MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP

Numrat e identifikimit referohen në figurat 7 ose 10.

1. Rrotullojeni në drejtim orar dorezën (nr. 38) për të rritur presionin në dalje ose në drejtim kundërorar për ta ulur atë.
2. Gjatë axhustimit, monitoroni presionin në dalje me një manometër prove.

Mbyllja

1. Mbyllni valvulën e bllokimit përpara rregullatorit në hyrjen e rregullatorit.
2. Mbyllni valvulën e bllokimit pas rregullatorit në daljen e rregullatorit.

3. Çlironi presionin pas rregullatorit duke hapur ngadalë valvulën e ajrit midis rregullatorit dhe valvulën e mbylljes pas rregullatorit. Pa ndryshuar axhustimin e sustës së rregullatorit, i gjithë presioni midis valvulave të mbylljes përpara dhe pas rregullatorit do të çlirohet përmes valvulës së ajrit, pasi rregullatori tip MR95L, MR95H, MR95HP ose MR95HT hapet si reagim ndaj presionit të reduktuar në dalje. Për rregullatorët tip MR95L, MR95H, MR95HP dhe MR95HT, mos i kryeni hapat 4, 5 dhe 6. Për tipat MR95LD, MR95HD dhe MR95HDP, vazhdoni hapat 4 deri 6.
4. Mbyllni valvulën e bllokimit në presionin e ngarkimit.
5. Shkarkoni ngadalë presionin e ngarkimit për të çliruar presionin në kutinë e sustës.
6. Shkarkoni ngadalë presionin në hyrje (përmes valvulës së ajrit) për të çliruar presionin që ka mbetur në rregullator.

Mirëmbajtja

PARALAJMËRIM

Për të evituar dëmtime personale fizike, dëmtime materiale ose të pajisjeve të shkaktuara nga çlirimi i papritur i presionit ose shpërthimi i gazit të akumuluar, mos u përpiqni të bëni mirëmbajtje ose çmontime pa izoluar më parë rregullatorin nga presioni i sistemit dhe pa çliruar plotësisht presionin e brendshëm nga rregullatori. Për të evituar dëmtime potenciale fizike nga susta ose mekanizmi drejtues i ngarkuar me presionin, sigurohuni që vida regjistruese të jetë e mbështetur plotësisht dhe që presioni i kutisë së sustës të shkarkohet para kryerjes së çmontimit. Në rast të kundërt, ngarkesa e sustës ose presioni i ngarkimit mund ta nxjerrë me forcë kutinë e sustës.

Rregullatorët e çmontuar për t'u riparuar duhet të kontrollohen nëse punojnë siç duhet para se të kthehen në shërbim. Duhet të përdoren vetëm pjesë të prodhuara nga Emerson për të riparuar rregullatorët Fisher™.

Për shkak të konsumit natyral ose dëmtimit që mund të ndodhë nga burime të jashtme, ky rregullator duhet inspektuar dhe mirëmbahet në intervale periodike. Shpeshhtësia e inspektimit dhe zëvendësimit të pjesëve varet nga shkalla e kushteve të vështira të shërbimit ose kërkesat e rregullave dhe rregulloreve vendore, shtetërore ose federale.

Për shkak të konsumit natyral që mund të ndodhë, pjesët duhen inspektuar në intervale periodike dhe duhen ndërruar, nëse është e nevojshme. Shpeshësia e inspektimit varet nga shkalla e kushteve të vështira të shërbimit ose kërkesat e ligjeve shtetërore ose federale.

Zëvendësoni, sipas nevojës, pjesë të tilla si unazat hermetizuese «O», permistopet, diafragmën dhe guarnicionet. Gjithmonë vendosni lubrifikantë ndërsa bëhet rimontimi i rregullatorit. Lubrifikantët e përshtatshëm tregohen në vizatimet e kompletit.

Për t'u çmontuar, nuk është e nevojshme që rregullatori të nxirret jashtë tubacionit. Të gjithë numrat e identifikimit referohen në figurat 4 deri 10.

Zëvendësimi ose mirëmbajtja e dizës ose fluturës së valvulës

Nëse ndodh që valvula të mos mbyllet hermetikisht, ka mundësi që diza ose flutura e valvulës të jenë konsumuar ose dëmtuar. Për t'i kontrolluar ose zëvendësuar, veproni si më poshtë.

1. Mbyllni rregullatorin. Për procedurën e duhur, shihni seksionin «Mbyllja».
2. Zhvidhosni udhëzuesin e fluturës së valvulës (nr. 5) nga trupi (nr. 1). Susta e fluturës së valvulës (nr. 26) dhe flutura e valvulës (nr. 4) normalisht do të dalin jashtë trupit së bashku me udhëzuesin e fluturës së valvulës. Te rregullatorët me madhësi të trupit DN 40 ose 50/1-1/2 ose 2 inç, edhe bishti (nr. 6) do të dalë jashtë trupit të rregullatorit.
